

Fjala e mbylljes së Prokurorit të Përgjithshëm znj. Arta Marku në prezantimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave

Ju falenderoj për prezantimin e bërë znj. Ministre!

Rekomandimet ishin mjaft të qarta dhe reflektojnë në të vërtetë prioritetet që duhet të kemi në luftën kundër kriminalitetit.

Gjej rastin që t'u kërkoj drejtuesve të prokurorive që të zbatojnë këto rekomandime dhe të dokumentojnë masat e marra në zbatim të tyre, pasi është një informacion që i kërkohet periodikisht Prokurorit të Përgjithshëm nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe pa një informacion të saktë prej jush, është praktikisht e pamundur që të kthejmë një përgjigje në cilësinë dhe afatin e kërkuar.

Gjithashtu, kërkoj prej jush që të vlerësoni me seriozitet situatën në të cilën ushtroni aktivitetin në rrethet përkatëse, duke vlerësuar në kohën e duhur informacionet që ju serviren nga Agjencitë Ligjzbatuese, duke i analizuar këto informacione, në bashkëpunim të ngushtë edhe me Policinë e Shtetit.

Duhet të kemi të qartë të gjithë që asnjë institucion nuk funksionon dot në mënyrë të shkëputur nga institucionet e tjera. Aq më pak mund të funksionojë në mënyrë të tillë prokuroria. Bashkëpunimi është jo vetëm një mënyrë për të pasur sukses në punën tonë, por është një detyrim ligjor, të cilin në asnjë mënyrë nuk mund ta anashkalojmë.

Duke e mbyllur, falenderoj edhe një herë ministren e Drejtësisë, zv/kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për praninë e tij mjaft domethënëse për ne, ju të nderuar kolegë, si dhe përfaqësuesit e medias.